

URDHËR
Nr. 447, datë 11.7.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Kulturës, zëvendësministrit të Ministrisë së Kulturës, znj. Meri Kumbe, nga data 13.7.2023 dhe datë 14.7.2023.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Kulturës, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ushtron këto përgjegjësi kryesore:

a) nënshkruan përgjigjet zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore për të gjitha çështjet që janë brenda fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Kulturës dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit të drejtimit administrativ të institucionit;

b) ndjek dhe kontrollon veprimtarinë e nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Kulturës.

3. Në ushtrimin e kompetencave, sipas këtij urdhri, zëvendësministri ndihmohet dhe mbështetet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës ose personi që ushtron detyrat e tij në rast mungese.

4. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

5. Ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Kulturës, znj. Meri Kumbe, për zbatimin e këtij urdhri.

6. Ngarkohet Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve për komunikimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti